



## **Njoftim për konsultimin publik, lidhur me projektligjin:**

### **“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 25/2024 ‘PËR SIGURINË KIBERNETIKE’”**

Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike” ka për qëllim përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor ekzistues në fushën e sigurisë kibernetike, me synim rritjen e nivelit të mbrojtjes së infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për parandalimin, zbulimin, reagimin dhe rikuperimin nga incidentet e sigurisë kibernetike.

Ky projektligj synon gjithashtu forcimin e rolit dhe kompetencave të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, përmirësimin e organizimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional përmes CSIRT-eve sektoriale, si dhe krijimin e mekanizmave të rinj të monitorimit dhe vlerësimit të përputhshmërisë, përmes detyrimit të vetëdeklarimit dhe raportimit nga operatorët e infrastrukturave të informacionit.

Në këtë kuadër, projektligji parashikon rregullimin e procedurave për deklarimin e hostimit dhe administrimin e sistemeve, rrjeteve dhe infrastrukturave të informacionit, si dhe krijimin e Grupit Ndërinstitucional të Inteligjencës Kibernetike, me qëllim përmirësimin e shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit strategjik ndërinstitucional.

Në tërësi, projektligji synon rritjen e efektivitetit të mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes, si dhe forcimin e masave administrative në rast të mosrespektimit të detyrimeve ligjore, në funksion të rritjes së sigurisë dhe qëndrueshmërisë së infrastrukturave dhe shërbimeve digjitale në Republikën e Shqipërisë, si dhe përafrimit të mëtejshëm me standardet dhe praktikatat e Bashkimit Evropian në fushën e sigurisë kibernetike.

Palët e interesuara ftohen të paraqesin komentet dhe rekomandimet e tyre për këtë projektligj, brenda 20 ditëve pune nga data e shpalljes së këtij njoftimi, në adresën e email-it: [ilir.dhimitri@aksk.gov.al](mailto:ilir.dhimitri@aksk.gov.al) dhe [endeida.vasi@aksk.gov.al](mailto:endeida.vasi@aksk.gov.al) si dhe në linkun <http://www.konsultimipublik.gov.al>.